



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULATOR PER FURNIZIMIN ME UJE DHE LARGIMIN E
PERPUNIMIN E UJRAVE TE NDOTURA

RAPORTI VJETOR

2009

**GJENDJA NE SEKTORIN UJESJELLES-KANALIZIME DHE VEPRIMTARIA
E ENTIT RREGULATOR TE UJIT**



Tirane, Janar 2010

Permbajtja

Hyrje . 3

➤ Parathenie. 3

➤ Misioni. 5

1. Gjendja ne Sektorin e Ujesjelles – Kanalizimeve. 6

- 1.1 Te per gjithshme mbi sektorin e ujit te pijshem dhe ujrate te ndotura. 6
- 1.2 Aktoret kryesore ne sektorin e Ujesjelles – Kanalizimeve. 8
- 1.3 Investimet ne sektorin e Ujesjelles – Kanalizimeve. 10
- 1.4 Operatoret qe veprojne ne sektorin e UK dhe Procesi i Transferimit te Aseteve. 11
- 1.5 Analiza e Tregut te sherbimeve per ujin e pijshem dhe ujrat e ndotura. 13
- 1.6 Gjendja e Sherbimit te Furnizimit me Uje. 15
 - 1.6.1 Te dhena te per gjithshme. 15
 - 1.6.2 Zonat e Sherbimit te Furnizimit me uje. 15
 - 1.6.3 Cilesia e Sherbimit te furnizimit me uje te Konsumatoreve. 17
 - 1.6.4 Analiza e Treguesve kryesore te performances te sherbimit per ujin e pijshem. 17
- 1.7. Gjendja e sherbimit te Largimit dhe Trajtimit te Ujrate te Ndotura. 26
 - 1.7.1 Te dhena te per gjithshme. 26
 - 1.7.2 Zonat e Sherbimit te largimit dhe trajtimit te ujrate te Ndotura. 26
 - 1.7.3 Cilesia e Sherbimit dhe Analiza e Treguesve kryesore te performances se sherbimit per ujrat e ndotura. 27
 - 1.7.4 Trajtimi i Ujrate te Ndotura. 29
- 1.8 Tarifat per sherbimet e ujit te pijshem dhe ujrate te ndotura. 31

2. Veprimtaria e Entit Rregulator te Ujtit (ERRU) per vitin 2009. 37

- 2.1 Baza Ligjore e Veprimtarise se ERRU. 37
- 2.2 Struktura Organizative. 38

- 2.3 Permiresimet dhe Ndryshimet Ligjore e Normative. 38
- 2.4 Forcimi Institucional e Organizativ i ERRU. 40
- 2.5 Aktivitetet e ERRU dhe Vendimet e Komisionit Kombtar. 41
- 2.6 Veprimitaria e ERRU ne lidhje me Licencimin e Operatoreve. 42
- 2.7 Veprimitaria e ERRU ne lidhje me Tarifat per konsum publik te ujit te pëjshem dhe sherbimin per ujrat e ndotura. 44
 - 2.7.1 Procesi i miratimit te tarifave. 45
 - 2.7.2 Krijimi i bazes se te dhenave. 49
- 2.8 Mbrojtja e Konsumatorit. 49
- 2.9 Aktiviteti Financiar i ERRU. 50
 - 2.9.1 Burimet e financimit. 50
 - 2.9.2 Asetet dhe shpenzimet operative. 52

Zhvillimet ne Sektorin e Ujesjelles–Kanalizimeve dhe Veprimitaria e ERRU gjate vitit 2010. 55

Hyrje



Hyrje

➤ **Parathenie**

Sektori i Ujesjelles Kanalizime ne Shqiperi eshte nje sektor shume i rendesishem permes te cilit sigurohet furnizimi me uje te pijshem dhe procesi i largimit dhe perpunimit te ujrate te ndotura. Ky sektor gjate vitit 2009 u vleresua si nje nder prioritet e Qeverise Shqiptare.

Proceset e zhvillimit dhe integrimit te vendit ne Bashkimin European, bejne qe dhe institucionet ne kete sektor te hartojne dhe aplikojne politika dhe aktivitete zhvillimi eficiente dhe afatgjata.

ERRU, si nje nga aktoret e rendesishem te ketij sektori eshte tejet e interesuar dhe aktiv te siguroje mbeshtetje maksimale ne zhvillimet e reja dhe sfidat ne sektorin ujesjelles kanalizime permes perm bushjes se mandatit dhe permiresimit te vazdueshem te instrumentave rregulator.

Gjate vitit 2009, Enti Rregulator i Ujit krahas perpjekjeve te vete forcimit institucional ka ushtruar nje rol teper aktiv ne sektorin e furnizimit me uje dhe largimit e trajtimit te ujrate te ndotura, nepermjet licencimit dhe procesit aprosimt te tarifave per operatoret.

Tashme eshte krijuar baza e te dhenave ne lidhje me licencimin dhe tarifat nga ERRU, fale dhe plotesimit te stafit dhe ambienteve te reja dhe bashkekohore te punes realizuar gjate vitit 2009.

Jane perzgjedhur disa tregues kryesore te performances se operatoreve mbi bazen e te cileve behet analiza e operatoreve ne vecanti dhe sektorit ne teresi.

Duke analizuar treguesit e mesiperm, pavaresisht se konstatohet nje permiresim ne shkalle vendi ne humbjet e ujit ne krahasim me vitin 2008, perseri mbetet problem niveli i larte i humbjeve .

Po keshtu matja e prodhimit dhe konsumit te ujit ne shkalle vendi vetem 42% mbetet nje nga problemet qe duhet trajtuar si prioritet ne planet e investimit te shoqerive. Zonat e mbulimit dhe faturimi ende jane problematike ne shume operatore.

Permiresime te pamjaftueshme konstatohen ne procesin e drejtimit ne shumicen e operatoreve. Keshillat mbikqyres duhet te luajne nje rol me aktiv ne kete drejtim.

Nje zhvillim pozitiv gjate vitit 2009, krahasuar me nje vite me pare, ishte rritja mesatare e te ardhurave te operatoreve te ujesjelles kanalizimeve. Per t'iu perqigjur strategjise se qeverise per reduktimin gradual te subvensionit ndaj operatoreve te UK, inkurajojme nje item me te larte te rritjes se te ardhurave te tyre.

Gjate vitit 2009, prane ERRU aplikuan per ndryshim tarife operatore te cilet operonin me tarifa te miratuara ne vitin 2003 si Sh.a Ujsjelles, Erseke , Bilisht, Peshkopi, Gramsh, Skrapar.Gjithashtu, ne vitin 2009, Sh.a.uk Vlore aplikoi per here te pare.

Gjej rastin te pershendet keto shoqeri per seriozitetin dhe angazhimin maksimal te treguar gjate procesit te aplikimit. Ne te njejten kohe ftojme dhe inkurajojme te gjitha shoqerite e tjera te ndjekin shembullin e shoqerive te permendura me lart, qe permes permiresimeve tarifore te mundesojne gradualisht arritjen e mbulimit te kostove totale te aktivitetit te tyre.

Ne inkurajojme nje zhvillim dinamik, konkurrent dhe eficient te tregut te furnizimit me uje dhe largimit e perpunimit te ujrate te ndotura, i cili ka ne fokus konsumatorin!

Ne jemi shume te interesuar ne nje bashkepunim aktiv me pushtetin vendor per te peraktuar objektiva ne nivelin e duhur ne procesin e tarifimit.

Do doja te falenderoja anetaret e komisionit kombtar si dhe stafin e ERRU per punen e madhe dhe perkushtimin e demonstruar gjete vitit 2009.

Falenderoj Qeverine Shqiptare per mbeshtetjen e vazhdueshme per forcimin dhe konsolidimin e ERRU-se duke e konsideruar si nje aktor teper te rendesishem ne sektorin e ujit.

Gjithashtu dua te falenderoj qeverine Gjermane per mbeshtetjen e rendesishme per ERRU-ne, permes projektit te financuar prej saj i cili po zbatohet ne bashkepunim me GTZ.

Enti Regulator i Ujit do te perpiqet te jete aktiv dhe kontribues ne procesin e zhvillimit te sektorit, permes permiresimit te vazhdueshem te instrumentave rregulatorre ne dobi te permiresimit te sherbimit me uje dhe largimit e perpunimit te ujrate te ndotura ne vend.

*Avni Dervishi
Kryetar i ERRU*

➤ **Misioni i ERRU**

- ❖ Te mbroje Interesat Publike te Konsumatoreve ne sektorin e furnizimit me uje dhe largimin e trajtimit te ujrate te ndotura.
- ❖ Te krijoje nje ambient transparent, ligjor e rregulator ne sektor
- ❖ Te promovoje efiçencen, sigurine dhe rritjen e cilesise se sherbimit te operatoreve.
- ❖ Te ndihmoje qeverisjen qendrore dhe lokale ne procesin e investimeve dhe te mireadministrimite te sistemeve te UK
- ❖ Te nxise konkurencen dhe pjesemarrjen e sektorit privat per sherbimet e ujit te pijsphem dhe ujrate te ndotura.

1.

Gjendja ne Sektorin Ujesjelles Kanalizime



1. Gjendja ne Sektorin e Ujesjelles Kanalizimeve

1.1 Te per gjithshme mbi sektorin e ujit te pijshem dhe ujrate te ndotura

Me reshje vjetore prej 800 deri ne 2000 mm, Shqiperia furnizohet me uje te bollshem. Burimet ujore (nentokesore dhe siperfaquesore) prodhojne deri ne 41,7 billion meter kub (BCM) qe i korrespondon nje sasie prej afro **1300 m³/sek** ose **12,800 m³ per person ne vit**. Burimet jane te shperndara ne menyre jo te njetrajtshme neper vend. Ato perdoren ne rradhe te pare per furnizimin me uje te banoreve.

Aktualisht sot prodhohet per furnizimin me uje te pijshem vetem **12-15 m³ /sek** ose afro 80 m³ per person ne vit.

Burimet siperfaquesore (Perrenjte, Lumenje e liqenit) jane me te shumta dhe perbejne mbi 77 % te burimeve te rigjeneruara. Ato nuk jane te shperndara ne menyre uniforme ne te gjithe territorin si dhe jane shume te ndryshueshme gjate periudhave te ndryshme te vitit.

Keto burime perdoren per furnizimin me uje te pijshem ne nje mase te vogel (vetem per qytetet Tirane dhe Kavaje) pas nje trajtimi qe ju behet ujrate siperfaquesore te tyre perkatesisht ne impiantet e trajtimit te ujit te pijshem ne Boville - Tirane dhe Maskuri - Kavaje.

Burimet e ujrate nentokesore jane gjithashtu te bollshme dhe perfaqesojne rreth 23% te totalit te burimeve te rigjeneruara. Ato jane te shperndara mire kudo neper vend dhe jane te shfrytezuara nga puset (ne lugina dhe fusha) dhe burimet (ne zonat malore). Burimet, megjithate shtrohen gjate stines se thate te veres.

Burimet nentokesore jane burime kryesore te ujit te pijshem. Rreth 70% e qyteteve kryesore ne Shqiperi furnizohen nga puset e ujrate nentokesore. Ujrat nentokesore jane te nje cilesie mjaft te mire ne burim

Sherbimi i furnizimit me uje te pijshem i referohet furnizimit me uje te konsumatoreve familjare ne zonat urbane dhe rurale. Ky sherbim u ofrohet edhe institucioneve buxhetore (shkolla, kopshte, spitale, reparteve ushtarake, intitucionet te qeverisjes qendrore e lokale, etj) si dhe kompanive private te biznesit te madh e te vogel.

Ky sherbim kryhet nepermjet menaxhimit te sistemeve perkatese te furnizimit me uje ne zonat perkatese. (shih skemen 1)


Gjithashtu, konsumatoret shqiptare perdonin edhe disa pajisje e mekanizma te tjere per te siguruar furnizimin me uje si:

- Depozitat e vogla metalike ose plastike mbi çati apo tarraca. Afro 70 % e konsumatoreve ne zonat urbane kane instaluar depozitat te tilla me kapacite 500 – 2000 litra.
- Puse shpimi te vogla. Afro 20% e popullsisë ne zonat rurale kane hapur puse te tilla private
- Furnizimi me uje me ane te autoboteve e cila eshte me e theksuar ne zonat urbane dhe turistike (Sarande, Berat, Durres,etj) gjate periudhes se veres per shkak te mungesave te furnizimin me uje

➤ Uji me shishe i cili kryesisht perdoret per pirje

Sherbimi i largimit dhe trajtimit te ujrale te ndotura perfshin grumbullimin dhe largimin e ujrale te ndotura nga konsumatoret familjare ne zonat urbane dhe rurale, konsumatoret private si dhe konsumatoret e tjere te institucioneve buxhetore. Vetem ne zonen e Kavajes dhe te Pogradecit, ky sherbim perfshin edhe trajtimin e tyre nepermjet impianteve te trajtimit te ujrale te ndotura.

Ky sherbim kryhet nepermjet menaxhimit te sistemeve perkatese te largimit te ujrale te ndotura si dhe nepermjet gropave septike dhe sanitare (shih skemen 1).



Skema 1.1 – Modeli i skemave te Sherbimit te ujit te pijshem dhe ujrale te ndotura
Burimi : ERRU

1.2 Aktoret kryesore ne sektorin e Ujesjelles – Kanalizimeve

Enti Rregulator i Ujit eshte nje autoritet i pavarur mjaft i rendesishem ne kete sektor dhe ka per detyre te mbroje interesat e konsumatoreve, te ndermarre masa per rritjen e sigurise, eficiences dhe cilesise se sherbimeve te furnizimit me uje tek konsumatori dhe te largimit e trajtimit te ujrate te ndotura, te nxise konkurrencen dhe investimet private ne sektorin e ujit, etj.

Pergjegjesia e ERRU fokusohet ne liçensimin e te gjithe personave fizike e juridike te perfshire ne shperndarjen e ujit te pijshem dhe sherbimeve te kanalizimeve te ujrate te ndotura. Gjithashtu, vepmintaria e ERRU eshte e fokusuar ne projektimin e modeleve te tarifave dhe miratimin e tarifave per sherbimet e furnizimit me uje te pijshem si dhe sherbimeve te largimit dhe trajtimit te ujrate te ndotura. ERRU ka **funkcion rregulator ne Sektor**.

Gjithashtu ne sektorin e Ujesjelles – Kanalizimeve veprojne shume aktore te rendesishem me funksione dhe detyra te peraktuara nga ligjet ne fuqi.

Keta aktore mund te klasifikohen ne dy grupe kryesore si me poshte:

➤ **Aktore ne nivel qendror te qeverisjes si:**

Keshilli i Ministrave (KM) i cili miraton politikat dhe strategjite kombetare ne sektorin e furnizimit me uje dhe largimit e perpunimit te ujrate te ndotura.

KM ka ndermarre nje reforme themelore qe ka per qellim vendosjen e nje demokracie konstitucionale te bazuar ne focimin e ligjit per operatoret qe veprojne ne sektor si dhe deçentralizimin e funksioneve qeveritare ne administrimin e ketyre sistemeve. Njekohesisht, KM eshte angazhuar per zbatimin e nje filozofie te re ne sektorin e UK ne drejtim te rajonalizimit dhe aggregimit te menaxhimit te sistemeve te Ujesjelles - Kanalizimeve

Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (MPPTT) e cila luan nje rol vendimtar ne procesin e permiresimit te situates se furnizimit me uje dhe largimit e trajtimit te ujrate te ndotura. Ajo eshte perqejese per planifikimin e strategjive dhe politikes ne sektorin e ujit, politikes se investimit nepermjet planifikimit dhe shperndarjes te fondeve te investimit, politikes subvencionuese dhe aseteve per shoqerite UK ne te gjithe vendin.

Gjate vitit 2009 nga kjo Ministri jane dhene **4, 78 miliard leke** per investime ne sektorin e furnizimit me uje dhe largimit e trajtimit te ujrate te ndotura.

Ministria e Financave eshte nje aktor i rendesishem ne sektor. Duke patur paraysh situaten aktuale financiare te Shoqerive te UK, roli i Ministrise se Financave eshte vendimtar ne pershpëtimin e etapave te reformes. Gjate vitit 2009 nga kjo Ministri nepermjet DPUK jane dhene **878 milion leke** per subvencionimin e Shoqerive te UK kryesisht per mbulimin e shpenzimeve per energjine elektrike dhe sigurimin e punonjesve.

Ministra e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrate (MMPAU) e cila eshte perqejese per menaxhimin e rezervave ujore si dhe per monitorimin dhe mbrojtjen e

mjedisit ne baze te ligjit Nr. 8934,dt. 05.09.2002. Kjo Ministri ushtron aktivitetin e saj ne terren me ane te Agjensive Rajonale te Mjedisit ne 12 Prefektura te vendit. Ato jane perqejese per zbatimin e legjislacionit ambientalist ne nivel lokal. Brenda kesaj Ministrie ushtron aktivitetin e tij Inspektorati Ambientalist i cili eshte nje organ i specializuar per mbrojtjen e Ambientit ne baze te ligjit Nr. 8934

Keshilli Kombetar i Ujit (KKU) i krijuar qe ne vitin 1996 me ane te ligjit Nr.8093 "Per Rezervat Ujore" ka nje rol kryesor ne mbrojtjen, zhvillimin dhe perdonimin e qendrueshem te burimeve te ujit. Ne baze te ligjit te mesiperm, KKU ka Sekretariatin teknik ne nivel kombetar dhe Keshillin e Baseneve ne nivel lokal. Keshillat e Baseneve jane autorite lokale qe sigurojne menaxhimin e burimeve te ujit perbrenda basenit ujor.

Ministria e Shendetesise e cila nepermjet Inspektoriatit Sanitar Shteteror dhe Institutut te Shendetit Publik eshte autoriteti sanitari qe monitoron cilesine e ujit te pijshe te shperndare ne popullate. Kjo Ministri luan nje rol mjaft te rendesishem ne kontrollin e cilesise se ujit te pijshe per te mos lejuar perdonimin e tij jasht standarteve te cilesise se ujit qe veprojne ne vendin tone.

Keshilli Bashkerendues (KB) dhe Komisioni i Mbrojtjes se Konsumatorit (KMK) te cilet jane krijuar ne baze te ligjit Nr. 9902,dt.17.04.2008. KB eshte perqejjes per shqyrtimin e politikave dhe masave organizative ne mbrojtje te konsumatorit ndersa KMK ka nje rol kryesor ne shqyrtimin dhe marrjen e masave per zbatimin e ketij ligji ne mbrojtje te konsumatoreve shqiptare.

Shoqata e Ndermarrjeve te Ujesjelles- Kanalizimeve e cila eshte nje shoqate profesioniste jo perfituese, e krijuar ne vitin 2000, per te perfaqesuar interesat e operatoreve te UK ne proceset e reformave ne sektor.

Gjithashtu aktore mjaft te rendesishem ne sektorin e furnizimit me uje dhe largimit e trajtimit te ujrale te ndotura jane edhe **donatoret e huaj** te cilet me ane te investimeve ne kete sektor kane dhene nje ndihmese te madhe ne permiresimin e situateve.

Gjate vitit 2009, **Donatoret e huaj kane dhene 4,08 miliard Leke** ne forme kredie dhe grantesh per investime ne sektorin e furnizimit me uje dhe largimit e trajtimit te ujrale te ndotura. Donatoret e Huaj bashkepunojne kryesisht me pushtetin lokal dhe Ministrite perkatese qe kane funksione investuese ne sektor. Kete vit ka filluar nje bashkepunim i tyre edhe me ERRU duke qene se ata jane mjaft te interesuar per administrimin e ketyre sistemeve ne te ardhmen.

Me poshte po japim nje liste te donatoreve kryesore te huaj ne kete sektor:

1. Banka Boterore
2. Qeveria Gjermane nepermjet KfW dhe GTZ
3. Komuniteti European nepermjet programit IPA
4. Banka Europeiane per Zhvillim
5. Qeveria Japoneze nepermjet JICA
6. Qeveria Zviceriane nepermjet SECO
7. Qeveria Austriake nepermjet ADA
8. Qeveria Italiane nepermjet Kooperacionit Italian
9. Qeveria Holandeze

➤ **Aktore ne nivel lokal te qeverisjes si:**

Aktoret kryesore ne sektorin e Furnizimit me uje dhe largimit e trajtimit te ujrate te ndotura ne nivel lokal jane **pushtetet lokale** ne nivel qarku, bashkie dhe komuna. Te gjitha operatoret e UK, me ane te ligjeve ne fuqi si dhe vendimeve te Keshillit te Ministrave, duhet te jene ne varesi te pushteteve lokale ne nivel Qarku dhe/ose Bashkie.

Pushtetet lokale, nepermjet Keshillave mbikqyres te krijuara prej tyre, jane perjegjese per administrimin sa me te mire te ketyre sistemeve si dhe te strukturave perkatese qe administrojne keto sisteme.

1.3 Investimet ne sektorin e Ujesjelles dhe Kanalizimeve.

Investimet ne sektorin e Ujesjelles kanalizimeve jane kryer kryesisht me fondet e Buxhetit te Shtetit si dhe nepermjet fondevet te donatoreve te huaj te dhene ne forme kredie ose grantesh. Fondet e investimeve jane dhene kryesisht per rehabilitimin e sistemeve te ujesjelles – kanalizimeve si dhe per ndertimin e impianteve te trajtimit te ujrate te ndotura. Gjithashtu nje pjese e ketyre fondevet po perdoret edhe per instalimin e matusave te ujit ne prodhimin e ujit te pijshem si dhe tek konsumatoret. Perdorimi i fondevet me te medha ne kete drejtim do te permiresoje ndjeshem administrimin e ketyre sistemeve dhe do te zvogeloje humbjet e ujit dhe shpenzimet e energjise elekrike per prodhimin e ujit te pijshem.


Eshte per tu theksuar se fondi total i investimeve ne kete sektor ne tre vitet e fundit kane gene ne rritje (shih tabelen dhe grafikun 1.2).

Tabela 1.3 – Investimet ne sektorin UK

Viti	Buxheti i Shtetit (leke)	Donatoret e huaj (leke)
2007	2,561,464,440	2,394,237,960
2008	3,228,861,625	4,286,275,000
2009	4,780,000,000	4,079,227,000

Burimi: MPPTT

Grafiku i Investimeve vendase dhe te huaja ne sektorin e UK



Sic shihet nga tabela dhe grafiku, fondet e Investimeve nga buxheti i shtetit ne vitin 2009 jane dyfishuar ne krahasim me vitin 2007.

Vihet re se ne rastet kur fondet e investimeve jane shoqeruar edhe me fonde e masa perkatese per administrimin e ketyre sistemeve, rezultatet ne permiresimin e treguesve te performances te operatoreve kane qene mjaft te mira. Shembuj te mire ne kete drejtim mund te permendim operatoret e SHA U-K Korce-qytet, SHA U-K Pogradec, SHA U-K Librazhd, SHA U-K Shkoder – qytet, etj

Shume pak investime behen ne sektor me fondet e vete operatoreve qe veprojne ne kete sektor apo nga fondet e pushtetit lokal. Investimet e ketyre te fundit jane kryesisht per mirembajtjen e ketyre sistemeve ose per raste emergjente.

1.4 Operatoret qe veprojne ne sektorin e UK dhe procesi i transferimit te aseteve.

Ne sektorin e Ujesjelles –Kanalizimeve ka **56 operatore** te cilet mbulojne te gjitha zonat urbane si dhe nje pjese te zonave rurale te vendit. Me poshte jepet lista e operatoreve si dhe numri i klienteve qe ju sherbehet ne sistemin e UK.



Tabela 1.4 – Operatoret ne sektorin UK dhe Numri i Klienteve

Nr	Emri i Operatoreve	Numri total i konsumatoreve te ujit te pijshem	Numri total i klienteve me sherbim ne sistemin e ujrate te ndotura
1	Bashkia Puke UK	1,069	962
2	Sarande UK Sh.A	6,921	6,356
3	Vau Dejes U Sh.A	769	-
4	Tropoje U Sh.A	1,665	-
5	Kruje UK Sh.A	3,514	2,460
6	Berat- Kucove UK Sh.A	23,503	19,930
7	Lezhe UK Sh.A	5,801	5,801
8	Pogradec UK Sh.A	12,091	8,573
9	Korce UK Sh.A	20,509	19,518
10	Elber UK sh.p.k	27,172	7,327
11	Shkoder UK Sh.A	25,838	21,364
12	Permet U Sh.A	3,359	-
13	Vlore U Sh.A	33,809	-
14	Durres UK Sh.A	69,891	52,449
15	Tirane UK Sh.A	149,687	149,130
16	Novosele U Sh.A	2,124	-
17	Kelcyre Sh.A	863	-
18	Puke fshat U	524	78
19	Shkoder (F) U Sh.A	1,704	-
20	Elbasan (F) U Sh.A	15,777	-
21	Korce (F) U Sh.A	5,335	-
22	Lushnje (F) U Sh.A	5,378	-
23	Gjirokaster (F) U Sh.A	530	-

24	Rubik UK Sh.A	503	484
25	Bilisht U Sh.A	1,617	-
26	Mirdite UK Sh.A	1,171	1,016
27	Fush Arrez UK Sh.A	571	507
28	Rrogohzine UK Sh.A	4,132	1,644
29	Fier UK Sh.A	23,910	19,175
30	Librazhd UK Sh.A	4,172	3,958
31	Fush-Kruje UK Sh.A	1,972	1,764
32	Kavaje UK Sh.A	18,194	5,365
33	Mallakaster UK Sh.A	3,836	1,336
34	Gjirokaster (Q) UK Sh.a	8,337	6,095
35	UK Lushnje (Q) Sh A.	8,448	6,530
36	Libohove UK Sh.A.	786	567
37	Selenice UK Sh.A	1,484	-
38	Peqin UK Sh.A	1,471	-
39	Peshkopi U Sh.A	3,229	-
40	Gramsh U Sh.A	3,788	-
41	Burrel UK Sh.A	3,717	3,110
42	Bulqize U Sh.A	2,662	-
43	Tepelene U Sh.A	2,733	-
44	Polican U Sh.A	1,644	-
45	Erseke UK Sh.A	1,661	1,650
46	Has U Sh.A	900	-
47	Corovode U Sh.A	1,752	-
48	Malsi e Madhe U Sh.A	1,855	-
49	Kukes U Sh.A	4,973	3,434
50	Kurban U Sh.A	5,288	-
51	Delvine U Sh.A	1,264	-
52	Divjake Sh.A U.	2,564	-
53	Ura-Vajgurore U Sh.A	2,411	-
54	Kraste UK Sh.A.	392	375
55	Patos U Sh.A	5,368	-
56	Orikum U	1,701	-

Burimi : ERRU dhe DPUK, viti 2009

Nga analiza e te dhenave te mesiperme rezulton se 87 % e popullsise mbulohet me sherbimin e furnizimit me uje nga keta operatore dhe vetem 61 % e popullsise mbulohet me sherbimin e sistemeve te largimit te ujrave te ndotura. Pjesa e popullsise qe nuk mbulohet me sherbim nga keta operatore eshte ne zonat rurale te vendit. Me poshte po japim keto te dhena ne forme grafike.

Grafiku 1.4 – Popullsia qe mbulohet me sherbim nga Operatoret ne sektorin UK

Burimi : ERRU

Ne baze te V.K.M nr. 660 date 12.09.2007 “ Per transferimin e aksioneve te Shoqerive te Ujesellesve dhe Kanalizimeve njesive te qeverisjes vendore”, brenda vitit 2009, te gjitha asetat e ketyre sistemeve duhet te kalonin ne pronesi te pushteteve vendore te cilat gjate ketij procesi duhet te konstitonin keshillat mbikqyres perkates.

Procesi i transferimit te ketyre aseteve i filluar gjate vitit 2007 vazhdoi edhe ne vitin 2009 por ende ne disa zona nuk eshte bere konstituimi i keshillave mbikqyres duke sjelle shume probleme ne lidhje me administrimin e ketyre sistemeve.

Per 10 operatore nuk jane krijuar keshillat e rind mbikqyres sipas vendimeve perkatese te KM. Me i theksuar ky problem eshte ne SHA UK Tirane dhe SHA UK Durres, SHA UK Elbasan ku proces eshte akoma i bllokuar.

1.5 Analiza e Tregut te Sherbimeve ne Sektorin e Ujesjelles Kanalizimeve

Aktivitetet e menaxhimit te furnizimit me uje te pijshem dhe largimit e trajtimit te ujrale te ndotura vazhdojne te jene **sherbime publike** te cilat jane mjaft te rendesishme per

mireqenien e shoqerise, shendetin public dhe sigurine kolektive te komuniteteve dhe bizneseve si dhe te mbrojtjes se ambientit. Keto sherbime udhehiqen nga parimet e aksesit universal, vazhdimesise dhe cilesise se sherbimit, efiçiences dhe çmimeve te pranueshme.

Tregu i sherbimeve ne kete sektor funksionon nepermjet shoqerive aksionere me pronar te aseteve pushtetin lokal. Jane bere disa tentativa per dhenien me koncesion te disa operatoreve si SHAUK Elbasan-qytet, SHAUK Durres, Lezhe, Fier dhe Sarande por aktualisht ne sektor nuk ka operatore me pronar shoqeri private.

Ne shume komuna te vendit, pushteti lokal i tyre i administron vete sistemet e furnizimit me uje nepermjet stafeve te tyre te cilet jane te pa licencuar nga ERRU. Kjo ndikon jo vetem ne mos menaxhim te mire te ketyre sistemeve por edhe ne uljen e sigurise se furnizimit me uje te pijsphem. Me i theksuar ky fenomen eshte ne qarkun e Fierit, Lezhes, Sarandes.

Ky fenomen eshte akoma me i rende ne sektorin e sherbimit te largimit te ujrate te ndotura. 28 Operatore te mesiperm (50 % e te gjithe operatoreve) nuk e ofrojne kete sherbim ne zonat e tyre te sherbimit. Ne keto zona ky sherbim ofrohet nga sektore te veçante prane pushteteve lokale.

Raste me tipike jane ne qytetin e Vlores, Patosit, Koplikut si dhe ne zonat jo urbane te Lushnjes, Korçes, Shkodres, Tepelene, Skrapar, Delvine, etj.

1.6 Gjendja e Sektorit te Furnizimit me Uje.

1.6.1 Te dhena te pergjithshme.

Furnizimi me uje behet kryesisht nepermjet perdonimit te ujratevave nentokesore, karakteristikat fiziko-kimike te cilave jane brenda standarteve, jane ujera te fresketa dhe me cilesi mjaft te mire. Disa operatore perdonin ujrat e burimeve siperfaqesore pa trajtim te vecante per arsyen se cilesia e tyre eshte brenda kushteve higjenosanitare te percaktuara nga standartet e cilesise se ujit te pijshtem (SHA UK Berat-Kucove, SHAUK Peshkopi, SHA UK Sarande, SHA UK Skrapar dhe Polican)

Vetem dy operatore perdonin ujrat siperfaqesore te lumenjve dhe liqeneve tane te cilat i trajtojne ne impiantet e trajtimit te tyre dhe me pas i dergojne ne sistemin e rezervimit dhe te shperndarjes (SHA UK Tirana e cila trajton ujrat e lumit te Tiranes ne impiantin e trajtimit te ujit te pijshtem me kapacitet deri ne 1600 l/sek dhe SHA UK Kavaja e cila trajton ujrat siperfaqesore te liqenit artificial te Maskurise me kapacitet aktual Q=25 l/sek)

Ne te gjitha sistemet e furnizimit me uje behet dezinfektimi i ujit te pijshtem. Ky trajtim behet prane rezervuareve ose stacioneve te pompave. Ne te gjitha qarqet e vendit funksionojne njesite e monitorimit dhe te kontrollit te cilesise se ujit te rrethit perkates, te cilet jane te atashuar prane Inspektoriatit Sanitar Shteteror. Keto njesi bejne matje te rregullta te cilesise se ujit dhe i dergojne te dhenat e tyre prane Institutit te Shendetit Publik Tirane, si dhe prane operatoreve qe veprojnë ne kete sektor.

Ne te gjithe vendin jane mbi 600 sisteme te furnizimit uje qe administrohen nga shoqerite e UK dhe pushtetet lokale te komunave. Keto sisteme kane probleme te medha kryesisht ne lidhje me humbjet e medha te ujit, amortizimin e tubacioneve per shkak te vjetësise se tyre si dhe me keqmenaxhimin e tyre nga vete operatoret. Mbi 50 % e sasise se ujit qe prodhohet nuk matet per shkak te mungeses se matesave ne vendet e prodhimit te ujit. Kjo eshte me theksuar ne sistemet e furnizimit me uje te komunave dhe te qyteteve te vogla.

Po keshtu matja e konsumit te ujit ne shkalle vendi qe aktualisht behet vetem ne 42 % te konsumatoreve, mbetet nje nga problemet qe duhet trajtuar si prioritet ne planet e investimit te operatoreve.

Operatoret e medhenj ne Tirane, Korce, Shkoder, Pogradec, etj i kane instaluar masesat ne prodhim. Gjithashtu keto sisteme kane humbje te medha te ujit per shkak te çarjeve te tubacioneve, lidhjeve ilegale ne zonat jo urbane, etj.

Megjithate, aktualisht, sasia e ujit qe prodhohet e mbulon kerkesen per uje te te gjithe konsumatoreve.

1.6.2 Zonat e Sherbimit te Furnizimit me Uje.

Sherbimi i furnizimit me uje me gjithe permiresimet e vazhdueshme vazhdon te jete me probleme ne Shqiperi, pasi ky sherbim nuk afrohet ne te gjithe vendin.

Megjithese numri i lidhjeve me sistemet e furnizimit me uje eshte rritur sidomos gjate viteve te fundit, te dhenat e vitiit 2009 tregojne se zonat e sherbimit me furnizim me uje nga operatoret perkates nuk mbulojne te gjithe territorin e vendit.

Duke analizuar kete çeshtje, rezulton se problemet me te medha jane ne mosbulimin nga ana e operatoreve te zonave rurale te vendit. Operatoret jane te perqendruar ne zonat urbane dhe ne shume zona rurale ky sherbim le per te deshiruar.

Levizja e popullsise nga zonat rurale ne zonat urbane ka zgjeruar zonat e sherbimit ne keto te fundit dhe njekohesisht ka krijuar edhe mjaft probleme per furnizimin e tyre me uje sidomos ne qytetet e medha si Tirana, Durresi, Fieri, Vlora, etj.

Sherbimi i furnizimit me uje nuk iu ofrohet te gjithe klienteve ne zonen e sherbimit si per arsyte teknike dhe per arsyte te nje menaxhimi jo te mire te zones se sherbimit nga ana e Operatoreve.


Operatoreve qe veprojne ne kete sektor si dhe pushteteteve lokale iu del per detyre te evidentojne dhe rregjistrojne te gjithe klientet ne zonen e tyre te sherbimit dhe te bejne perpjekjet e tyre maksimale per t'iu ofruar kete sherbim te gjithe klienteve te tyre.

Njekohesisht, pushteteteve lokale dhe operatoreve ju del per detyre te zgjerojne zonat e sherbimit te furnizimit me uje. Kjo mund te realizohet nepermjet riorganizimit te operatoreve si dhe procesit te rajonalizimit te sektorit. Ky proces kerkon studime te detajuara dhe te thelluara per te patur arritje sa me te mira si dhe nje menaxhim efektiv te sistemeve te furnizimit me uje. Gjate vitiit 2009 jane vene re disa tentativa per zgjerimin e ketyre zonave si ne rrethin e Peqinit por qe akoma nuk ka rezultate konkrete.

Gjithashtu vihet re nje tendence e copetimit te zonave te sherbimit ne operatore te vegjel ne nivel komunash apo qytete te vogla te cilat kane krijuar probleme jo vetem ne menaxhimin e vete sistemeve por edhe ne uljen e cilesise se sherbimit, rritjes se shpenzimeve dhe fuqise pughtore per 1000 kliente si dhe ne rritjen e tarifave te ujit te pijshem.

Detajet per zonat e sherbimit te furnizimit me uje jepen ne harten bashkelidhur.

HARTA E ZONAVE TE SHERBIMIT TE FURNZIMIT ME UJE NGA OPERATORET



Burimi:Enti Rregulator i Ujit

1.6.3 Cilesia e Sherbimit te furnizimit me uje te konsumatoreve


Cilesia e Sherbimit te furnizimit me uje te konsumatoreve vazhdon te jetë e dobet. Kjo konsiston ne mosfurnizimin e vazhdueshem te klienteve me uje te pijsphem, ne mossigurimin e presionit te duhur te ujit prane konsumatoreve, ne vonesat e riparimeve te difekteve te konstatuara, etj.

Shume pak operatore ofrojnë furnizim me uje panderprerje te konsumatoreve. Te tilla janë SHA UK Korca- qytet, SHA UK Librazhdi, SHA UK Pogradeci, SHA UK Shkodra-qytet, te cilat u sigurojnë klienteve te tyre 24 ore uje.

Operatoret qe rezultojne me keq ne kete drejtim jane ShA UK Durres, SHA UK Malesi e Madhe, SHA UK Korce fshat, SHA UK Lushnje fshat, etj te cilat furnizonjne me pak se 6-8 ore ne dite.

Sipas te dheneve te Njesise se Monitorimit dhe Benchmark prane DPUK per vitin 2009 shkalla e furnizimit me uje te popullates varionte nga 4 deri ne 24 ore uje ne dite me nje mesatare prej **11.4 orash** ne dite per te gjithe qytetet e vendit. Me poshte po paraqesim ne forme grafike numrin e operatoreve me cilesi te larte sherbimi, me cilesi mesatare dhe me cilesi te dobet.

Grafiku 1.6 – Oret e sherbimit te furnizimit me uje nga Operatoret



Burimi: Njesia e Monitorimit dhe Benchmark, DPUK, MPPTT

1.6.4 Analiza e treguesve kryesore te performances se sherbimit per ujin e pijshem.


Rezultatet e punes se nje operatori qe kryen furnizimin me uje varet nga nje seri faktoresh. Nder to perfshihen faktoret e meposhtem:

- Nese operatori ofron vetem sherbimin e furnizimit me uje apo sherbimin e furnizimit me uje dhe largimin e trajtimin e ujrave te ndotura,
- Nese operatori sherben ne zona urbane apo rurale,
- Madhesia e zones se sherbimit,

- Lloji i sistemeve te prodhimit (me gravitet apo me ngritje mekanike),
- Madhesia dhe koha e investimeve,
- Lloji i pronesise, etj.

Ne per gjithesi çdo operator ne Shqiperi e siguron sherbimin e furnizimit me uje nga dy ose me shume sisteme, ose i kombinuar prodhimi ujesjellesi, te cilet mund te jene me rrjedhje te lire dhe ngritje mekanike. Lloji i sistemit te prodhimit te ujit eshte i rendesishem, sepse ndikon ne koston e energjise, e cila eshte një komponent mijt i rendesishem i kostos se operimit.

Me poshtë eshte paraqitur ne menyre te permblehdhur informacioni mbi llojin e sistemeve te prodhimit te ujit.



Burimi : Njesia e Montorimit dhe Benchmark, DPUK, MPPTT


Sipas ketyre te dheneve, 47% e ujit prodhohet nga sistemet me rrjedhje te lire dhe ngritje mekanike, 44% nga sistemet me ngritje mekanike dhe 9% nga sistemet me rrjedhje te lire.

Treguesit kryesore qe ERRU i konsideron te rendesishme gjate analizes se performances se nje operatori per sherbimin e ujit te pijshem jane:

Uji i pafaturuar.


Ky tregues eshte shume domethenes ne lidhje me rezultatet e punes se nje operatori. Uji i pafaturuar ndryshe quhet uje i humbur. Nje pjese e humbjeve i perkasin humbjeve reale dhe/ose teknike ne sistem, si dhe humbjeve te cilat jane te pashmangeshme dhe ndryshojne ne varesi te llojit te sistemit. Humbjet e tjera vijnë si pasoje e defekteve fizike ne sistem, rrjedhjeve per shkak te lidhjeve te paidentifikuara, apo lidhjeve qe perdoruesit bejne jashtë matesit te ujit.

Niveli mesatar i humbjeve ne vitin 2009 rezulton te jete rreth 70% .Tendenca e ketij treguesi eshte ne ulje. Niveli mesatar i humbjeve ne vitin 2009 krasuar me vitin 2008 eshte ulur rreth 2%.



Burimi : Njesia e Monitorimit dhe Benchmark, DPUK, MPPTT

Sic shihet edhe me siper humbjet e ujit/ uji I pafaturuar eshte ne nivele mjaft te larta. Duke e krasuar me disa vende te rajonit dhe te Europeve, vendi yne vazhdon te jete shume larg standardeve europiane ne kete drejtim (shih grafikun)




Burimi: Njesia e Monitorimit dhe Benchmark, DPUK, MPPTT dhe Wikipedia.org

Gjithashtu me poshte po japim edhe Grafiket qe tregojne renditjen e shoqerive sipas nivelit te humbjeve krasuar me mesataren



Burimi : Njesia e Monitorimit dhe Benchmark, DPUK, MPPTT



Burimi i te dheneve: Njesia e Montorimit dhe Benchmark, DPUK, MPPT

Niveli i larte i humbjeve mbetet nje nga problemet kryesore ne performancen e operatoreve, pasi ndikon negativisht ne gjendjen financiare te shoqerive. Kostoja e prodhimit te ujit rritet duke qene se prodhohet uje me shume sesa eshte e nevojshme. Kjo kosto eshte shume me e madhe ne rastet e sistemeve me ngritje mekanike per arsyte te perdonimit te energjise dhe tarifave te larta, te cilat jane rritur edhe gjate vitit 2009 .

Nuk evidentohen burime potenciale te te ardhurave per shkak te perdoruesve qe nuk faturohen apo qe nuk jane te rregjistruar.

Nga ana tjeter po aq serioz eshte fakti qe humbje te tilla cojne ne shperdorim te burimeve ujore te vendit.

Prandaj humbjet e ujtit duhen konsideruar si problem kryesor dhe duhen bere te gjitha perpiekjet per reduktimin e tyre


Konsum i matur.

Uji si çdo mall tjeter duhet te paguhet. Çdo klient deshiron te paguaje per ate qe ai konsumon, por situata e deritanishme tregon se vetem 42 % e sasise se ujitet te faturuar matet.

Pjesa me e madhe e operatoreve e kryejne faturimin e klienteve te tyre me mates dhe aforfe. Shume operatore nuk kane instaluar matesat e konsumit dhe faturimi behet vetem aforfe si per shembull ne SHA UK Vlore, Gjirokaster, Kurbin, Tropoje, Puke etj.. Disa te tjere kane vendosur matesat e ujit per te gjithe konsumatoret si SH A UK Librazhd, Poqradec, Korca (Qytet), etj.


Shoqerite po punojne per vendosjen e matesave, por edhe pse sherbimi i matur ne vitin 2009 eshte rritur rreth 2% ne krahsim me vitin 2008, mbetet akoma per te bere ne kete drejtim. Fakti qe matet vetem 42 % e ujit te faturuar si dhe fakti qe 70 % e ujit humbet, tregon se vendosja e matesave te ujit tek konsumatoret duhet te jete prioritet edhe tek investimet ne kete sektor. Pervoja ka treguar se vendosja e matesave redukton kerkesen per uje dhe ndihmon ne mire planifikimin e te qjithe elementeve te sistemit.

Grafiku i faturimit te matur per vitet 2008-2009.




Burimi : Njesia e Monitorimit dhe Benchmark, DPUK, MPPTT

Gjithashtu per te bere nje vleresim te operatoreve ne kete sektor po jepim ne forme grafike edhe renditjen e operatoreve sipas nivelit te sherbimit te matur krahasuar me mesataren



Burimi: Njesia e Monitorimit dhe Benchmark, DPUK, MPPTT

Shoqeri me faturim mbi mesatare



Burimi : Njesia e Monitorimit dhe Benchmark, DPUK, MPPTT


- Disa operatore qe kryejne sherbimin e furnizimit me uje nuk kane aplikuar per pajisje me liçence per ushtrimin e veprimtarise konform ligjit, megjithese vlen te theksohet se ky numer sa vjen e behet me i vogel.
- Disa njesi te qeverisjes lokale kane krijuar sektore prane tyre qe operojne ne sektorin e largimit te ujrate te ndotura pa marre nje liçence te miratuar nga ERRU dhe ne kundershtim me Ligjin Nr. 8102.

2.7 Veprimtaria e ERRU ne lidhje me Tarifat per konsum publik te ujit te pijshem dhe sherbimin per ujrat e ndotura.

Gjate vitit 2009, ERRU ka zhvilluar nje veprimtari aktive ne lidhje me tarifat e ujit per konsum publik dhe sherbimin e ujrate te ndotura. Ky aktivitet eshte perqendruar ne keto drejtime kryesore:

- Procesi i miratimit te tarifave
- Krijimi i bazes se te dhenave.

2.7.1 Procesi i miratimit te tarifave

Sektori ekonomik dhe monitorimit bazuar ne metodologjine per vleresimin e kostos dhe miratimin e tarifave si dhe akteve te tjera nenligjore e normative, ka vleresuar dhe ka dhene mendimin e tij lidhur me aplikimet per miratim tarife. Ky sektor mbeshtet me punen e tij Komisionin Kombetar Rregulator per te arritur ne nje vendimmarje sa me te drejte ne procesin e miratimit te tarifave te ujit per konsum publik.

Ne vitin 2009 kane aplikuar per miratimin e tarifave te sherbimit te furnizimit me uje dhe largimit te ujrate te ndotura keto shoqeri;

1. Sh.A.Ujeselles Kanalizime Berat Kuçove
2. Sh.A.Ujeselles Kanalizime Pogradec
3. Sh.A.Ujeselles Erseke
4. Sh.A.Ujeselles Bilisht
5. Sh.A.Ujeselles Peshkopi
5. Sh.A.Ujeselles Gramsh
7. Sh.A.Ujeselles Kanalizime Korçe
8. Sh.A.Ujeselles Kanalizime Fier
9. Sh.A.Ujeselles Vlore
10. Sh.A.Ujeselles Skrapar
11. Sh.A.Ujeselles Kanalizime Lezhe
12. Sh.A.Ujeselles kanalizime Durres

Nga te cilat:

4 Operatore si Sh.A.U.K.Pogradec, Berat- Kuçove, Fier dhe Korçe, kane aplikuar per ndryshimin e tarifave te sherbimit te furnizimit me uje te pijshem dhe largimit te ujrate te ndotura.

6 Operatore si Sh.A.U.Erseke, Bilisht, Peshkopi, Gramsh, Vlore, Skrapar kane aplikuar vetem per ndryshimin e tarifave te sherbimit te furnizimit me uje dhe dy operatore, Sh.A.U.K Lezhe dhe Durres kane aplikuar per vendosjen e tarifes se shitjes se ujit me shumice ne Komune.

Ne aplikimet per ndryshimin e tarifave ne vitin 2009 ne krahasim me vitin 2008 u vune re disa veçori;

- Per here te pare u paraqit aplikimi i nje operatori te rajonalizuar siç ishte Sh.A.Ujeselles Kanalizime Berat-Kuçove, e cila eshte quajtur edhe pioneri i ketij procesi. Aplikimi i ketij operatori krahas dokumentacionit te paraqitur sipas kerkesave te metotikes "Mbi vendosjen e tarifave te ujit per konsum publik" u shoqerua edhe Planin e Biznesit te hartuar me mbeshtetjen e Valu ADD Management Services.
- Per here te pare nga Sh.A.U.K Pogradec ne aplikimin per ndryshimin e tarifave egzistuese per sherbimin e furnizimit me uje dhe largimin e ujrate te ndotura u kerkua vendosja e nje tarife te re , "tarife e sherbimit". Kjo shoqeri kryen

sherbimin e furnizimit me uje ne nje zone turistike ku nje pjese e konsiderueshme e konsumatoreve nuk jane rezidente pasi banesat perdoren ne menyre sezonale dhe gjithashtu kjo zone ka nivel te larte emigracioni. Shoqeria pavaresisht ne se konsumatoret konsumojne ose jo uje te pijshem, eshte e detyruar te mirembaje rrjetin shperndares, kosto e cila duhet te paguhet nga te gjithe konsumatoret.

- Kane paraqitur aplikimin per ndryshimin e tarifave operatore si Sh.A. Ujesjelles Erseke, Biliشت, Peshkopi, Gramsh, Skrapar, te cilat nuk kishin aplikuar per ndryshimin e tarifave per shtate vjet.
- Ka paraqitur aplikimin per miratimin e tarifave te ujit te pijshem per here te pare Sh.A.U. Vlore.
- U paraqiten dy aplikimeve per vendosje te tarifes per shitje ujit me shumice nga operatoret SHA UK Durres dhe Lezhe. Keto operatore do ti shesin uje pushtetit lokal te Komunave dhe ato do te kryejne faturimin dhe arketimin tek konsumatoret. Marredheniet dysheshe jane percaktuar ne aktmarreveshjet e nenshkuara ndermjet tyre. Sejcila prej ketyre aplikimeve pati veçorite e saj. Kjo dukuri pavaresisht nga specifikat e veçanta shenon nje hap te ri ne bashkepunim ndermjet pushtetit vendor si autoritet perqiegjes per sigurimin e sherbimeve ne zonen e tyre dhe operatoreve qe ofrojne sherbimin e furnizimit me uje si njesi te specializuara. Gjithashtu shoqerite duke punuar ne baze marreveshje dysheshe kane mundesi te arketoje te ardhurat me me lehtesi, e pse jo mund te themi se ky eshte edhe nje hap drejt rajonalizimit te sherbimeve.

Mbi bazen e te dhenave te paraqitura jane analizuar treguesit tekniko ekonomik per secilin nga sherbimet, tendeca e tyre, rezultatet e arritura si dhe faktoret qe ndikojne ne percaktimin e tarifave te sherbimeve qe shoqeria kryen.

Te dhenat kryesore te marra ne analize jane, prodhimi dhe sistemi i furnizimit me uje, numri i popullsise ne zonen e sherbimit, numri i popullsise qe operatori ju ofron sherbimet, numri i klienteve, faturimi dhe humbjet, kosto e sherbimit, te ardhurat.

Mbi bazen e ketyre te dhenave eshte analizuar tendenza e disa treguesve kryesore te punes si mbulimi i zones me sherbimet qe operatori kryen, kosto e prodhimit dhe faturimit per nje m^3 uje te prodhuar dhe te shitur, sasia e ujit te faturuar per nje klient, mbulimi i kostos operative apo kostos totale me te ardhura, norma e arketimit, etj.

Analiza ka konsistuar jo vetem ne krahasimin e te dhenave dhe treguesve te punes mbi bazen e te cilave operatoret kane parashikuar ndryshimin e tarifave me ato te periudhes paraardhese, ne raste te veçanta edhe me te dhenat dhe treguesit e punes se dy apo me shume viteve te meparshme, por edhe ne analizen e te gjithe faktoreve qe ndikojne ne ndryshimin e tyre.

E pare ne kete kendveshtrim analiza e treguesve tekniko ekonomik eshte bere per secilen nga operatoret qe ka aplikuar per miratimin e tarifave duke evidentuar problemet me kryesore per secilen prej tyre, shkaqet dhe mundesite e permiresimit te tyre.

Konkluzionet e arritura nga analiza e aplikimeve te paraqitura per vitin 2009 jane:

Prodhimi i ujit te pijshem.

Me perjashtim te Sh.A.U.K Korçe dhe Pogradec ne te gjitha shoqerite e tjera volumi i ujit te prodhuar nuk matet por vleresohet, pra mungojne matesit e prodhimit.

Mbulimi i zones se juridiksonit me sherbime.

Shoquerite nuk mbulojne me sherbime te gjithe klientet ne zonen e juridiksonit.

Rezultate me te mira ne kete drejtim i kane Sh.A.U.K.Korçe dhe Pogradec te cilat mbulojne me sherbimin e furnizimit me uje 100% te popullsise ne zonen e sherbimit, Shoquerite e tjera kane mbuluar me sherbim nga 70% deri ne 90 % te popullsise ne zonen e sherbimit.

Numri i klienteve te lidhur me sistemin e furnizimit me uje dhe largimit te ujrate te ndotura ka ardhur duke u rritur, por megjithate ky sherbim ende nuk ju afrohet te gjithe klienteve. Sherbimi i largimit te ujrate te ndotura per gjithesht i ofrohet klienteve ne zonat urbane. Detyre e rendesishme per te gjitha shoquerite ujesjelles kanalizme mbetet evidentimi dhe rregjistrimi i te gjithe klienteve ne zonen e sherbimit duke synuar ofrimin e sherbimeve per te gjithe klientet ne zonen e tyre te sherbimit.

Vazhdimesia e kryerjes se sherbimit

Me gjithe permiresimet e bera per te tu siguruar klienteve uje panderpreje te gjithe konsumatoreve ky rezultat ende nuk eshte arritur. Pjesa me e madhe e shoqerive e kryejne furnizimin me uje sipas nje grafiku te percaktuar dhe vetem disa prej tyre e ofrojne kete sherbim 24 ore panderprerje si Sh.A.U.K.Pogradec, Korçe, Librazhd, Gramsh.

Uji i Pafaturuar.

Nga analiza e te dhenave te aplikimeve te paraqitura te dhenat e vitit 2009 tregojne se uji pafaturuar perfaqeson nga 30 % per Sh.A.U.Erseke, Korçe deri ne 70 % tek Sh.A.U.K Berat- Kuçove.

Krahasuar me vitin 2008 tendencia e ketij treguesi eshte eshte ne ulje. Te gjitha shoquerite kane ulur nivelin e humbjeve ne masen 2-4 % krahasuar me nivelin e tyre me vitin 2008. Megjithate niveli i larte i humbjeve mbetet nje nga problemet kryesore ne performancen e shoqerive. Reduktimi i humbjeve te ujit duhet konsideruar si problem kryesor dhe duhen bere te gjitha perpjekjet per uljen e nivelit te tyre.

Konsumi i matur

Te paguash per ate ç'ka konsumon si dhe per çdo mall tjeter edhe per konsumin e ujit do te ishte situata me ideale. Te dhenat tregojne se jemi ende larg ketij objektivi. Megjithate, konsumi i matur per gjithesht ne vitin 2009 krahasuar me vitin 2008 eshte rritur.

Nga analiza e aplikimeve rezulton se vetem pak shoqeri kane te instaluar matesat e konsumit per te gjithe konsumatoret si Sh.A.U.K Korçe e Pogradec, Per Sh.A.U. Bilisht e Kuçove gjithashtu ky tregues eshte i kenaqshem mbi 70% e konsumatoreve jane te pajisur me matesa. Por ne disa shoqeri ky tregues eshte i ulet si per Sh.A.U. Erseke apo Gramsh ku sherbimi i matur ze me pak se 20%.

Pervoja ka treguar se kerkesa per uje reduktohet ne mase te ndjeshme me vendosjen e matesave. Matja e konsumit ndihmon ne mireplanifikimin e te gjithe elementeve te sistemit.

Norma e arketimit.

Norma e arketimit per shoqerite ujesjelles kanalizime qe kane aplikuar per ndryshimin e tarifave ne vitin 2009 paraqitet e mire. Ne krahasim me vitin 2008 ky tregues ka ardhur ne rritje. Niveli mesatar i arketimit per keto shoqeri nga 85 % ne vitin 2008 ka arritur mbi 90% ne vitin 2009.

Ketu vlen te permendet Sh.A.U.K.Pogradec e cila kete tregues e ka mbi 100%, cka tregon se shoqeria ka bere perpjekje per arketimin edhe te detyrimeve te prapambetura duke ulur numrin e debitoreve te kesaj shoqerie.

Shoqeri si Gramshi e Peshkopia duke e konsideruar arketimin e te ardhurave problemi kryesor te punes se tyre kane marre masa konkrete per arritjen e ketij objektiv duke aplikuar nderprejen e furnizimit me uje per konsumatoret problematike e deri ne paditjen e tyre ne gjykate.

Mbulimi i kostos direkte dhe kostos totale

Objektivi i çdo njesie ujesjelles kanalizime eshte te mbuloje koston totale me te ardhurat qe gjeneron vete. Deri tani shoqerite ujesjelles kanalizime nuk kane mundur te mbulojne kostot e sherbimit me te ardhurat e tyre. Qeveria ka vazhduar te subvencionoje keto shoqeri per mbulimin e kostove te ketyre sherbimeve.

Me te ardhurat e realizuara nga aktiviteti i saj vetem Sh.A.U.K.Pogradec ka mbuluar me te ardhurat e saj si koston operative dhe koston totale , shoqerite e tjera mbulojne mesatarisht vetem 85% te kostos operative. Permiresimi ne kete drejtim eshte tendenca ne rritje e ketij treguesi.

Shoqerite e marra ne analize per vitin 2009 me perpjekjet e tyre jo vetem per arketimin e te ardhurave por edhe me permiresimin e punes ne drejtim te rritjes se numrit te klienteve, uljen e nivelit te humbjeve dhe rritjen e tarifave shoqerite kane arritur te permiresojne kete tregues. Krahasuar me vitin 2008 ne vitin 2009, shoqeri si Sh.A.U.Peshkopi, Gramsh, Erseke e kane permiresuar kete tregues. Ne vitin 2008 keto shoqeri mbulonin me te ardhurat e tyre respektivisht 85 %, 84% dhe 94 %, ne vitin 2009 ato mbulojne 100 % te kesaj kostoj.

Tarifat e miratuara ne vitin 2009 kane qene ne rritje. Rritja e tarifave eshte konsideruar nje domosdoshmeri objektive me qellim qe shoqerite te kene mundesi te rritin te ardhurat nga aktiviteti i tyre per mbulimin e kostos si dhe rritjen e cilesise se sherbimit ndaj konsumatoreve duke synuar uljen e subvacioneve te dhene nga qeveria.

Komisioni Kombetar Rregullator e konsideron tarifen si nje nder elementet kyc te harmonizimit te interesa te operatorit dhe konsumatoreve. Rritja e tarifave eshte bere duke marre ne konsiderate vleresimin e performances se shoqerive dhe faktoreve qe ndikojne ne permiresimin e saj me qellim qe klientet te perfitojne sherbimeve brenda standarte, te qendrueshem e me kosto sa me te arsyeshme.

Permiresimi i treguesve te punes, rritja e tarifave dhe investimeve do te sjellin padyshim permiresimin e situates financiare dhe per pasoje rritjen e cilesise dhe sigurise se sherbimeve per te gjithe konsumatoret.

2.7.2 Krijimi i bazes se te dhenave

Krijimi i nje baze te dhenash (deri tani i munguar), perpunimin e tyre per vleresimin e treguesve te punes per shoqerive ujesjelles kanalizime si nje nga detyrat e ketij sektori eshte domozdoshmeri per te patur rezultate sa me te mira ne vleresimin e sistemit tarifor ne per gjithesi dhe vecanerisht ne vendimmarjen per miratimin e tarifave.

Kjo baze te dhenash nuk eshte konsideruar si qellim me vete. Njohja dhe vleresimi i zbatimit te sistemit tarifor ne sektor krijuan mundesi per te marre masa per permiresimin e saj. Keshtu u konstatuan dhe u solllen ne kohe kontratat me shoqerite te cilave i kishte mbaruar afati i perdonimit te tarifave te miratuar. Shume shoqeri si Sh.A.U.Skrapar, Gramsh, Erseke, Bilosht, operonin me tarifa te miratuara ne vitin 2002-2003.

Kontaktimi me keto shoqeri, diskutimi, mbeshtetja me transparency e Entit Rregullator te Ujit per zhvillimin e procedurave per aplikimin e ndryshimit te tarifave beri te mundur qe keto shoqeri te paraqitnin aplikimet per ndryshimin e tarifave brenda vitiit 2009.

Gjithashtu te dhenat e paraqitura nga shoqerite te cilat gjate vitiit 2009 kane aplikuar per ndryshimin e tarifave jane perpunuar dhe paraqitur ne menyre te permbledhur duke percaktuar disa tregues kryesore te performances se shoqerive, minimalisht per periudhen ushtrimore dhe ate te parashikuar e ne disa raste edhe per 2-3 vite.

Vleresimi i performances se shoqerise mbi baze treguesish dhe ecurise se tyre ka ndihmuar Komisionin Kombetar Rregullator per nje vendimarrje sa me drejte ne procesin e miratimit te tarifave .

2.8 Mbrojtja e Konsumatorit

Ne baze te objektivit kryesor te ligjit Nr. 8102, dt. 28.03.1996 "Mbi kuadrin rregullator te sektorit te furnizimit me uje dhe largimit e perpunimit te ujrate te ndotura" i ndryshuar me ligjin Nr. 9352, dt. 03.03.2005 dhe ligjin Nr. 9584 dt. 17.07.2006 dhe Ligjin Nr. 9915 date 12.05.2008 i shprehur ne nenin 2 si dhe te misionit te tij, ERRU ka patur ne qender te vemendjes edhe mbrojtjen e Konsumatorit. Kjo mbrojtje eshte bere ne tre drejtime:


- Mbrojtja e Konsumatorit ndaj çmimeve monopol te operatoreve. Ne kete drejtim, ERRU eshte bere barriere per kerkesat e disa operatoreve per rritje te tarifave per ujin e pijshem dhe ujrat e ndotura pa argumente perkatese dhe pa permiresim te treguesve te tjere te performances.
- Mbrojtja e Konsumatorit ne drejtim te nje sherbimi te sigurt nga operatore me aftesi teknike dhe profesionale. Ne kete drejtim, ERRU ka bere licencimin e

operatoreve te afte qe kane patur ne drejtimin e tyre teknik inxhiniere me eksperience pune dhe ne perputhje me kerkesat e ligjt dhe te VKM

- Mbrojtja e konsumatorit ne drejtim te cilesise se sherbimit ndaj tyre nga operatoret qe veprojne ne sektor. Ne kete drejtim, ERRU eshte bere me aktiv jo vetem per te degjuar zerin e konsumatoreve por edhe per te kerkuar llogari prane operatoreve per plotesimin e kerkesave dhe ankesave te tyre ne drejtim te cilesise se sherbimit. Ne raste te caktuara ERRU ka nderhyre direkt prane operatoreve per zgjidhjen e kerkesave te konsumatoreve.

Gjithashtu, ERRU ka marre ne analize ne menyre te vazhdueshme edhe marredheniet e konsumatorit me operatorin. Gjate interesimit te ERRU ne kete drejtim eshte verejtur se shumica e operatoreve kane zyrat e marredhenieve me publikun ku marrin direkt ankesat e tyre te cilat rregjistrohen dhe u jepen sektoreve per zgjidhje. Vetem 9 operator kryesisht ne qytetet e vogla nuk kane liber te regjistrimit te ankesave. Me poshte po jepim ne menyre grafike, rezultatet e investigimit per rregjistrimin e ankesave te konsumatorit ndaj operatoreve

Grafiku i ankesave te konsumatoreve



Burimi : ERRU

2.9 Aktiviteti Financiar i ERRU

Garantimi i pavaresise rregulator te ERRU eshte i kushtezuar edhe nga pavaresia financiare e tij. Nisur nga ky kusht, ne ligjin nr.8102, dt. 28.03.1996, i ndryshuar, eshte percaktuar se financimi i ERRU behet nga pagesat rregulator te ato te licencimit, si forma me e pershatshme e financimit te rregulator te ekonomik, praktike kjo per shumicen e vendeve ku zbatohet rregjimi i rregullimit ekonomik per sherbimet publike.

2.9.1 Burimet e financimit

Ne nenin 10 te ligjit nr. 8102, date 28.03.1996, i ndryshuar, eshte sakteuar se burimet e financimit te operacioneve te ERRU jane:


- Pagesat e rregullimit;

- Pagesat per licencimet e operatoreve;
- Donacione te ndryshme.

Ne total te ardhurat e realizuara per vitin 2009 jane ne shumen 18 milion e 358.5 mijë leke.

Te ardhurat vjetore te realizuara sipas burimeve.

Emertimi	Ne 000/ leke
Totali	18.358.5
Pagesa rregullatore	17.381
Pagesa per licencimet	560
Interesa bankare	417.5



Burimi: ERRU

Siq duket qarte nga grafiku i mesiper, pagesa rregullatore perben 95 % te te ardhurave vjetore te ERRU dhe eshte burimi kryesor i financimit te gjithe operacioneve te tij, ndaj po ndalemi me gjere per te veshtruar zhvillimet ketij viti ne lidhje me pagesat rregullatore.


Detyrimi vjetor i kontraktuar, me operatoret e ujesjelles kanalizimeve, per pagesat rregullatore per vitin 2009 eshte ne shumen **24 milion e 570 mijë leke**.

Nga ky detyrim, operatoret gjate vitit 2009 kane likujduar **17 milion e 381 mijë leke**. Arketimi i pagesave rregullatore te vitit 2009, ne raport me detyrimin e percaktuar ne kontratat vjetore te ketij viti eshte ne masen 60.8%.

Ecuria e detyrimeve dhe pagesave rregullatore ne tre vitet e fundit

Vitet	Detyrimi Vjetor	Pagesa Vjetore	Detyrimi Mbetur
2007	21480	15765	14488
2008	22818	24896	12410
2009	24570	17381	19599

Burimi: ERRU



Nga analiza e ecurise se pagesave rregullatore rezulton se Shoqerite UK , qe operojne ne sektorin e furnizimit me uje dhe te largimit e perpunimit te ujerave te ndotura, jane ekonomikisht dobet, ballafaqohen me humbje te medha te prodhimit, kane perqindje te uleta ne arketimin e faturave, si dhe detyrime te konsiderueshme ndaj sigurimeve shoqerore dhe OSSH.

Ne keto kushte, disa prej tyre nuk shlyejne rregullisht pagesat rregullatore ndaj ERRU, duke reflektuar per pasoje rritje te vazhdueshme te detyrimeve te ERRU ndaj buxhetit te shtetit.

Shoqerite me detyrimet me te medha te pashlyera ne vite, per pagesat regulatore jane:

Sha Uk Fieri	5.735 milion leke
Sha UK Shkoder qytet	3.487 milion leke
Sha UK Kavaje	2.024 milion leke
Sha UK Elbasan qytet	1.740 milion leke
Sha UK Lezhe	1.267 milion leke

Arketimi i detyrimeve ne perputhje me kontratat do te garantonte pavaresine financiare te ERRU.

2.9.2 Asetet dhe Shpenzimet Operative

Gjate ketij viti kemi patur rritje te aseteve te institucionit, nga perdonimi i fondit te investimeve per rikonstrukcionin dhe per blerje pajisje te ndryshme per kompletimin e ambienteve te reja te punes.

Vlerat e aktiveve te qendrueshme te ERRU nga viti i krijimit te ERRU e deri me 31.12.2009 ka arritur ne 14.452.381 leke, e konkretisht:

Rritja e aktiveve te qendrueshme gjate vitit 2009

Lloji i aktiveve te qendrueshme	Me 31.12.2008	Me 31.12.2009
Pajisje, instalime, rikonstruksione, inventari ekonomik	4.456.431	8.362.381
Mjete transporti	6.090.000	6.090.000
Totali	10.546.431	14.452.381

Burimi: ERRU

Ne zbatim te nenit 11, te ligjit nr.8102, i ndryshuar, ERRU harton planin vjetor te shpenzimeve operative, te cilin nepermjet Ministrise se Financave e paraqet per miratim ne Keshillin e Ministrave.

Plani vjetor i shpenzimeve te ERRU, i miratuar nga Keshilli i Ministrave ka burim financimi vetem pagesat rregullatore dhe pagesat per licencsimet. Ne keto kushte ERRU, duhet te siguroje vete mbeshtetjen financiare per ushtrimin e aktivitetit dhe permbushjen e misionit te tij, si dhe duhet te harmonizoje te ardhurat me shpenzimet vjetore.


Plani i shpenzimeve operative te ERRU per vitin 2009, eshte miratuar nga Keshilli i Ministrave me VKM nr.1552, date 26.11.2008, "Per miratimin e fondit te shpenzimeve, per vitin 2009, te ERRU.....", per shumen **24.500.000 leke**.

Me kerkese te ERRU per rikonstrukcionin e ambienteve te reja te punes qeveria aprovoi me VKM nr.628, date 11.06.2009, nje shtese prej 2.800.000 lekesh, ne fondin vjetor te shpenzimeve te ERRU, duke e rritur fondin vjetor te shpenzimeve operative te ERRU per vitin 2009, ne shumen **27.300.000 leke**.

Fondi vjetor i shpenzimeve operative te ERRU sipas zerave.

Emertimi i shpenzimit	Plani
Paga	15.000.000
Sigurime shoqerore	3.000.000
Sherbime e furniture	5.000.000
Investime	4.300.000
Totali	27.300.000

Burimi: ERRU




Ne se fondi i planifikuar i shpenzimeve operative te ERRU per vitin 2009 eshte 27.300.000 leke, te ardhurat e realizuara gjate ketij viti jane 18.358.500 leke.

Me fonde e miratura nga Keshilli i Ministrave per vitin 2009, eshte synuar garantimi i kushteve optimale per pune, sigurimi i bazes materiale te domosdoshme per permbushjen e detyrave funksionale te Komisionit dhe gjithe stafit punonjes.

Fondet e planifikuara ne zerin investime jane shpenzuar 2.410.099 leke per projektimin dhe rikonstrukcionin e ambienteve te reja te punes dhe 1.494.901 leke kompletimin e zyrave me pajisje dhe kompjutera. Perdorimi i ketyre fondeve eshte kryer ne çdo rast duke zbatuar procedurat perkatese te prokurimit ne perputhje te plete me ligjin "Per prokurimet publike". Ne zerin shpenzime e furniture shpenzimet per sherbimet jane ne shumen 2.435.milion leke, shpenzimet per blerje te mallrash ne shumen 877 mijë leke. Diferencia prej 1.551 milion leke eshte perdorur per shpenzime udhetimi e dieta, pagese kuotacioni ne organizma nderkombetare etj.

Realizimi i shpenzimeve per vitin 2009 ne 000/leke

Emertimi i shpenzimit	Realizimi
Paga	12.614
Sigurime shoqerore	1.706
Sherbime e furniture	4.863
Investime	3.905
Totali	23.088



Zhvillimet ne Sektorin Ujesjelles – Kanalizime dhe Veprimtaria e ERRU gjate vitit 2010



Zhvillimet ne Sektorin e Ujesjelles–Kanalizimeve dhe Veprimitaria e ERRU gjate vitit 2010.

Zhvillimet ne sektorin e Ujesjelles-Kanalizimeve gjate vitit 2010

Zhvillimet ne sektor do te vazhdojne ne drejtim te permiresimit te furnizimit me uje, permiresimit te sherbimit te largimit dhe trajtimit te ujrale te ndotura, permiresimit te administrimit te ketyre sistemeve nga operatoret, etj

Miratimi i buxhetit te shtetit ku investimet ne sektorin e Ujesjelles kanalizimeve do te vazhdojne te jene ne nivele me te larta se investimet e dhena gjate vitit 2009 eshte nje baze e mire per permiresimet ne kete sektor. Keto investime jane parashikuar te jene kryesish per rehabilitimin e sistemeve ekzistuese te furnizimit me uje si dhe sistemeve te largimit e te grumbullimit te ujrale te ndotura.

Gjithashtu, edhe fonde nga donatoret e huaj ne forme kredie dhe grantesh do te vazhdojne te jene te larta. Keto fonde do te jene kryesish per permiresimin dhe rehabilitimin e sistemeve te ujrale te ndotura ne zonat urbane si dhe trajtimin e tyre nepermjet impianteve qe po ndertohen ne disa zona. Eshte parashikuar te perfundojne, brenda vitit 2010, ITUN i Durrësit,Sarandës,Lezhe-Shengjin,Vlores.

Keto investime do te jene edhe ne drejtim te permiresimit te furnizimit me uje ne zonat bregdetare dhe turistike si dhe per ndertimin e sistemeve te ujit te pijshem ne zonta rurale

Investimet e mesiperme do te kene ndikimin e tyre ne permiresimin e situate ne kete sektor por njekohesisht do te kene ndikimin e tyre ne rritjen e tarifave te sherbimit per ujin e pijshem dhe ujrat e ndotura.

Paralelisht me rritjen e investimeve , duhet te rritet edhe cilesia e administrimit te tyre, nga operatoret e ketyre sistemeve si dhe rritja e angazhimit dhe kontributit te pushteteve lokale per permiresimin e treguesve te performances te operatoreve qe veprojne ne kete sektor.

Nje prej problemeve qe duhet te zgjidhen gjate vitit 2010 duhet te jete konstituimi i keshillave mbikqyres te operatoreve qe nuk e kane perfunduar kete proces. Perfundimi i ketij procesi do te bente te mundur zgjidhjen e shume problemeve te tjera qe lidhen me mireadministrimin e ketyre sistemeve. Per kete arsye duhet nje bashkepunim me i ngushte midis Ministrise se Ekonomise, Pushteteve lokale dhe ERRU per zgjidhjen e ketij problemi.

Krahas perfundimit te procesit te mesiperm, gjate vitit 2010 do te vazhdoje edhe procesi i nisur i rajonalizimit/agregimit te operatoreve te furnizimit me uje dhe largimit e trajtimit te ujrale te ndotura. Ky proces duhet te vazhdoje jo vetem nepermjet nje studimi te hollesishem te gjendjes aktuale te ketyre operatoreve dhe zonave te sherbimit te tyre por edhe nepermjet hartimit te nje master plani te sistemeve Ujesjelles-Kanalizimeve per te gjithe vendin.

Gjithashtu nje vemendje e vecante gjate vitit 2010 i duhet kushtuar dhe zvogelimit te humbjeve te ujit ne sistemet e furnizimit me uje (Uji pa te ardhura) te cilat jane ne nivele shume te larta (afro 70 %). Nje nder masat kyce qe do te ndikonte ne uljen e ketyre

humbjeve do te jete instalimi i matesave te medhenj te ujit ne sistemin e prodhimit te ujit te pijsphem si dhe instalimi i matesave te ujit tek konsumatoret familiare dhe ata private. Ne te njejten kohe operatoret e ketyre sistemeve duhet ti kushtojne vemendje kontrollit dhe kalibrimit te matesave te ujit qe jane instaluar aktualisht ne keto sisteme.

Viti 2010 do te jete edhe vitit i pare i zbatimit te kodit te ujit nga te gjithe operatoret. Ky proces do te ndiqet nepermjet një bashkepunimi konkret te te gjithe aktoreve qe jane ngarkuar me zbatimin e tij. Ne kete proces duhet ti kushtohet vemendje jo vetem njohjes dhe sinqerimeve te hollesishme te ketij kodi por edhe ngritjes se kapaciteteve institucionale, administruese dhe teknike te vete operatoreve.

Gjate vitit 2010 do te vazhdoje edhe procesi i nisur i hartimit te planeve te biznesit per perspektiven 4-5 vjecare te aktiviteve te operatoreve te ketij sektori. Hartimi i ketyre planeve do te ndikoje pozitivisht edhe ne parashikimet afatmesme te permiresimit te treguesve te performances gjate menaxhimit te ketyre sistemeve si dhe te ndryshimeve te studjuara te tarifave per sherbimet e ujit te pijsphem dhe ujrate te ndotura. Keto tarifa duhet te shkojne drejt mbulimit te pote te kostove te operimit, mirembajtjes dhe investimit ne keto sisteme.

Veprimtaria e ERRU gjate vitit 2010

Veprimtaria e ERRU gjate vitit 2010 do te fokusohet kryesisht ne disa drejtime si me poshte:

- ❖ Permbushja e Misionit te ERRU.

Gjate te gjithe aktiviteve te ERRU gjate vitit 2010, do te kihet parasysh realizimi i misionit te saj ne drejtim te mbrojtjes se konsumatoreve, te krijimit te ambientit transparent e rregulator ne sektor, te rritjes se cilesise se sherbimit, te nxitjes se konkurencës dhe pjesmarrjes se sektorit privat, te mbeshtetjes se operatoreve dhe qeverisjes qendrore e lokale ne procesin e investimeve efektive e cilesore ne sektor.

- ❖ Rritja e sigurise se sherbimit te furnizimit me uje dhe largimit te ujrate te ndotura nepermjet licencimit te te gjitha subjekteve qe veprojne ne kete sektor.

ERRU gjate vitit 2010 do vazhdoje aktivitetin e saj jo vetem per te perfunduar procesin e licencimit te te gjithe operatoreve qe veprojne ne sektor ne perputhje me VKM 958, dt.06.05.2009 por edhe te licencimit te operatoreve te tjere te rinj qe do te kerkojne te punojne ne kete sektor ne perputhje me kerkesat e ligjit Nr.8102 dhe VKM perkatese. Nje vemendje e vecante do ti kushtohet edhe licencimit te operatoreve te rinj ne fushen e largimit dhe trajtimit te ujrate te ndotura.

- ❖ Mbrotja e Konsumatorit nepermjet jo vetem rritjes se sigurise se sherbimit por edhe nepermjet miratimit te tarifave te arsyeshme nga pikpamja tekniko – ekonomike.

ERRU, gjate vitit 2010, do te vazhdoje te zbatoje detyrat e dhena nga ligji ne lidhje me procesin e analizes dhe miratimit te tarifave te reja ne sektorin e furnizimit me uje dhe largimit e trajtimit te ujrate tendotura. Ne kete proces, do te kihet parasysh mbrojtja e konsumatoreve nepermjet miratimit te tarifave te pranueshme prej tyre ne varesi te

cilesise se sherbimit, mbulimit te kostove per operimin, mirembajtjen dhe ndertimit e rehabilitimin e tyre. Ky proces do te jete transparent, analistik, i hapur dhe integrues.

❖ Zbatimi i detyrave dhe objektivave te projektit te GTZ

I gjithe ekipi i ERRU eshte i vethet per rendesine e realizimit me sukses te projektit te GTZ te filluar per mbeshtetjen institucionale te institucionit. Ne bashkepunim te ngushte me konsulentet e GTZ do te vazhdojme punen e nisur per te gjitha permiresimet qe do te behen ne institucionin e ERRU per te permbushur te gjitha detyrat dhe objektivat e percaktuara ne kete projekt.

❖ Realizimi i detyrave ne lidhje me zbatimin e kodit te ujit nga te gjithe operatoret

ERRU do te marre pjese aktive ne kete proces duke filluar me njohjen e ketij kodi nga te gjithe operatoret, sqarimet e hollesishme ne lidhje me zbatimin e tij, nenshkrimin dhe zbatimin e tij nga palet e caktuara, etj.

❖ Permiresimi i vazhdueshem institucional dhe organizativ i ERRU

ERRU do te vazhdoje procesin e plotesimit te struktures organike te stafit. Ne buxhetin e miratuar te ERRU per 2010 jane planifikuar fondet e nevojshme per plotesimet e nevojshme te struktures. Gjithashtu gjate vitit 2010 do te studohet edhe riorganizimi i sektoreve dhe i struktures se ERRU.

❖ Ngritura e kapaciteve te stafit te ERRU

Gjate vitit 2010 do te vazhdojne perpjekjet per ngritjen e kapaciteve te stafit te ERRU. Pervec seminareve apo takimeve te punes qe do te organizohen ne kete drejtim ne kuader te projektit te mesiperme te GTZ do te behen perpjekje per ngritjen e ketyre kapaciteteteve nepermjet punes se perditshme si dhe nepermjet organizimit te trajnimeve te vecanta per specialistet e sektoreve percate.

❖ Rritja e transparencës se veprimtarise se ERRU

Rritja e transparencës se veprimtarise te ERRU do te konsistoje jo vetem ne pasqyrimin e hapur te kesaj veprimtarie tek te gjithe aktoret nepermjet faqes se hapur te internetit e cila do te permiresohet ne menyre te vazhdueshme. Veprimtaria e institucionit do te jete e hapur per te gjithe nepermjet nje procesi bashkepunues, ligor e rregulator me te gjithe aktoret e mesiperme.

❖ Rritja e bashkepunimit me institucionet qe veprojne ne sektorin e ujit brenda dhe jashte vendit

Gjate vitit 2010, ERRU do te ndermarre nje sere aktivitetesh dhe do te marre pjese aktive ne takime pune me synimin e permiresimeve te sherbimit ne sektor, forcimit te bashkepunimit te te gjithe aktoreve qe veprojne ne sektor si dhe ne kuader te rritjes se transparencës se veprimtarise se saj.

Gjithashtu, bashkepunimi me Entet Rregulator me analoge dhe Institucionet te tjera qe veprojne ne sektorin e sherbimeve per ujin e pijshem dhe ujrat e ndotura ne Europe do te jete ne fokusin e aktiviteteve te ERRU.

